20888

161/3

BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË**

**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. Q-28092/3 prot. Tiranë, më 21/12/2022

**Lënda:** **Kthim përgjigje**

**QENDRËS "RES PUBLICA"**
**Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë**

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-28092, datë 01.12.2022 dhe ka kaluar për shqyrtim te Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. Q-28092/2, datë 20.12.2022 si më poshtë:

"Në përputhje të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" akteve nënligjore në zbatim të tij, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore", Planit të Përgjithshëm Vendor të qytetit të Tiranës miratuar me vendimin nr. 1 të Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 14.04.2017, Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka miratuar Planet e Detyruara Vendore për zonat e prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Sa i përket projektit "Për zonën e re për zhvillim, në Njësitë Administrative 4 dhe 8, zona "5 Maji", miratuar me VKM-në nr. 78, datë 31.01.2020, Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka miratuar Planin e Detyruar Vendor (PdyV), miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 5779/12, datë 03.04.2020 rishikuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 12281/1, datë 30.03.2022".

Bashkëlidhur do të gjeni një kopje të këtij Plani të Detyruar Vendor (PdyV).

Lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

**Blerta Goxha**

Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

tirana

BASHKIA
TIRANË

**VENDIM**

Nr. 12281/1, date 30.3 2022

**"Për miratimin e Planit të Detyruar Vendor, të Zonës së Re Për Zhvillim në Njësinë Administrative 4 dhe 8, Zona "5 Maji", Bashkia Tiranë (i ndryshuar)**

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b" dhe nenin 23, pika 14 të ligjit nr 139/2015, date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenin 13, pika "dh" te ligjit nr.107/2014, datë 31 07.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar), urdheresen nr.28116, datë 24 07.2017 te Kryetarit të Bashkisë "Për procedurat e hartimit dhe miratimit te planeve te detajuara vendore" (e ndryshuar); urdhrin nr.11987, datë 20 04.2016 të Kryetarit të Bashkise "Për ngritjen e Keshillit Teknik te Bashkisë së Tiranës" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik te Bashkisë Tiranë, miratuar me vendimin nr.11987/1, date 20.04 2016 të Kryetarit të Bashkisë (i ndryshuar), , VKM Nr. 887 datë 24.12.2019 "Për Përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, VKM Nr. 85, datë 09.02.2022 "Për ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 78, datë 31 1.2020, të Këshillit te Ministrave, "Për shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim në Njësinë Administrative 4 dhe 8, Zona "5 Maji", Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si Njësi Zbatuese", si dhe procedurës se miratimit te lejeve te zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore" (i ndryshuar);

**VENDOSA:**

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor, të Zonës së Re Për Zhvillim në Njësinë Administrative 4 dhe 8, Zona "5 Maji", Bashkia Tiranë (i ndryshuar)

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, zbardhjen e dokumentacionit përfundimtar dhe hartës.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e këtij vendimi në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ERION VELIAJ

SHESHI SKËNDERBEJ NO1 · KODI POSTAR 1001 · TIRANË SHQIPËRI · TEL +355 (4) 2251951 / 0800 8888 · EMAIL INFO@TIRANA.GOV.AL



MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

z. Erion VELIAJ